

## **Arbi AGALLIU**



**Datëlindja:**01.08.1984

**Vendlindja:**Vlorë

**Email:**Arbi.Agalliu@parlament.al

### **Jetëshkrimi**

Prof. Asoc. Dr. Arbi Agalliu ka kryer studimet në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik, Dega Ekonomiks (2004-2008). Pas përfundimit të studimeve universitare ka kryer studimet Master në Studime Ekonomike Evropiane në “Bamberg University” Gjermani si dhe në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik (2008-2010).

Arbi Agalliu është Doktor i Shkencave Ekonomike si dhe mban titulli Profesor i Asociuar në Ekonomi. Ai ka një përvojë mbi 10 vite në mësimdhënie në nivel universitar, eksperiencë pune disavjeçare në ndërmjetësit financiarë në Shqipëri si banka dhe kompani sigurimi në çështje që lidhen me kontrollin e brendshëm (auditimin), produktet dhe shërbimet financiare, kapitalin human, etj. Ka mbajtur pozicione të ndryshme në sektorin e arsimit të lartë si Drejtues i Shkollës Doktorale, Përgjegjës Departamenti, Zëvendës Rektor, Administrator, etj. Gjithashtu ka punuar si Senior Internal Audit pranë Emporiki Bank – Credit Agricole Bank, agjent marrje në sigurim pranë INSIG SHA, pedagog i jashtë pranë Universitetit të Tiranës – Fakulteti Ekonomik – Departamenti Ekonomiks; Universitetit “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, Fakulteti Ekonomik – Departamenti Financës; Universitetit “Ismali Qemali” Vlorë – Fakulteti Ekonomik – Departamentit Financës, etj. Ka publikuar artikuj shkencor në revista të njohura shkencore brenda dhe jashtë vendit si dhe kurse të ndryshme specializimi mbi administrimin dhe menaxhimin e kapitalit human në biznese pranë Universitetit të Graz-it Austri; mbi kontrollin e brendshëm në sistemin bankar dhe kapitalit human në vende si Greqi, Leysin- Zvicër, Glasgow Angli, etj.

Ka qenë pjesëmarrës në aktivitete të ndryshme akademike në universitete ndërkombëtare në Itali, Sllovakia, Rumani, Finland, Spanjë etj. organizator dhe pjesëmarrës në aktivitete të ndryshme shkencore lidhur me “Sistemin bankar“, “Kapitalin human“, “Kompanitë e

sigurimeve“, etj. Ka punuar gjithashtu si Administrator i Deleguar i Universitetit “Barleti” si dhe pedagog i lëndëve “Institucionet dhe Tregjet Financiare”, “Sistemi Bankar dhe Financiar”, “Menaxhimi i Burimeve Njerëzore”, “Auditim”, etj.

Që nga viti 2014 dhe aktualisht është Kordinatori Kombëtar i Partisë Demokratike, Anëtar i Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike (2014-2018).

Aktualisht është Deputet i Kuvendit të Shqipërisë në Legjislaturën e IX si dhe Sekretar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Shqipërisë.